



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 994 Date 14-12 2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
“ UJESJELLES - KANALIZIME ” MALLAKASTER SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 “ Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare” ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise “ Ujesjelles - Kanalizime ” MallaKaster, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 30.8 % nga Bashkia Ballsh, 23.1 % nga Komuna Qender Dukas, 11.7 % nga Komuna Aranitas, 12.5 % nga Komuna Hekal, 9 % nga Komuna Kute dhe 12.9 % nga Komuna Fratar, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore”.

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit” Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI
GENC RULI